

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.K., nga Prishtina... , për shkak të veprës penale Kanosje, nga neni 185 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit R.K.,- av. A.Gj., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.1244/2017, datë 21.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-ës , më datë 06.04.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës e mbrojtësit të të akuzuarit R.K., av. A.Gj., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.1244/2017, datë 21.03.2017, ndryshohet vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarin R.K., për veprën penale penale Kanosje, nga neni 185 par. 2 të KPRK-së për të cilën është shpallur fajtor e gjykon me dënim me kusht, me te cilin dënimin e shqiptuar me burgim nga Gjykata e shkalles se pare në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve e merr si të vërtetuar dhe urdhëron që i njëjti të mos ekzekutohet nëse ky i akuzuar në afat prej 1(një) viti nuk kryen veprë të re penale. Të akuzuarit koha e kaluar në paraburgim nga data 23.02.2017 e deri me datë 06.04.2017 i llogaritet në dënimin e shqiptuar. Të akuzuarit i ndërprehet paraburgimi. Në pjesët tjera aktgjykimi i ankimuar ngel i pandryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë P.nr.1244/2017, datë 21.03.2017, të akuzuarin R.K., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par. 2 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së të njëjtit. Në këtë dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 23.02.2017, të akuzuarit R.K. i është llogaritur në dënimin e shqiptuar deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar. I akuzuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro). Palët e dëmtuara D.K. dhe F.I. për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civilo – juridik.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të të akuzuarit R.K., av. A.Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vendimin mbi sanksionin penal dhe vendimit mbi vazhdimin e paraburgimit, me propozim që Gjykata e

Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit t'i shqiptoj dënim të kushtëzuar si dhe ndaj të njëjtit ti ndërpritet paraburgimi.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr. 368/2017, datë 28.03.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konform dispozitave të nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën me kohë dhe në mënyrë të rregullt i njoftoj palët, si Prokurorin e Apelit, të akuzuarin R.K., të dëmtuarit D.K. dhe F.I. si dhe mbrojtësin e të akuzuarit av. A.Gj., në seancën e kolegjit prezantuan të dëmtuarit D.K. dhe F.I., i akuzuari R.K. i sjellur nga burgu i Dubravës, dhe mbrojtësi i të akuzuarit av. A.Gj., kurse prokurori edhe pse i njoftuar në kohë nuk morri pjesë në seancë. I dëmtuari D.K. ndaj të akuzuarit nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon parashtron kërkesë pasuroro juridike . E dëmtuara F.I. ndaj të akuzuarit nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon parashtron kërkesë pasuroro juridike . Mbrojtisi i të akuzuarit propozoj që të aprovohet si e bazuar ankesa e të tije dhe propozoi që ndaj të mbrojturit të tije të ndërprehet paraburgimi. I akuzuari në tersi i mbështeti pretendimet e mbrojtësit të tije dhe shprehë pendimin e tije për veprën e kryer.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Me ankesë mbrojtësi i të të akuzuarit pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga dispozita e nenit 384 par 1 pika 1.12 të KPP e lidhur me nenin 370 par 8 të KPP, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i paqart dhe kontradiktor në mesë veti dhe në funde të fundit është edhe i papërmbarueshëm, për faktin se në pjesën e dispozitivit ku shqiptohet dënimi me burgim në pasuesin e parë thuhet se i pandehuri dënohet me dënim me burgim në kohzgjatëje prej 3 muajve i cili dënim do të ekzekutohet pasë plotfuqishmëris së këti aktgjykimi, ndërsa menjëherë në pasuesin tjetër e që është në kundërshtim me pasuesin e parë thuhet i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 23.02.2017 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar deri sa aktgjykimi të merre formën e prerë por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e mësipërme ankimore të akuzuarit nuk janë të bazuara, aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë, apo shkelje të tjera të cilat gjykata e shkallës së dytë në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së i vëren detyrimisht. Aktgjykimi i shkallës së parë, pra edhe dispozitivi është mjaft i qartë dhe pa kundërthënie me vetveten dhe me faktet e cekura në arsyetim. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, nuk përmban

kundërthënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Pretendimet e mbrojtës rrethe paqartsive të cekura në ankesën e mbrojtës të të akuzuarit kjo gjykatë i kuptoi si gabime teknike dhe të njetat i evitoi me ndryshimin e këti aktgjykimi.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Mbrojtësi i të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimin mbi dënimin duke theksue se për këto vepra penale rrallë nga gjykata shqiptohen dënime me burgim duke propozuar që dënimi me burgim ti zavendosihet me dënim me kushte me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Gjykata e shkallës së parë konform nenit 73 të KPRK-së, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç'rast si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori parasysh faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë, sjelljen korrekte të tij në gjykatore, sinqeritetin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, pendimin e tij për veprën e kryer, kërkim faljen të dëmtuarve për veprën e kryer, ndërkaq nuk ka gjetur rrethana rënduese dhe veçanërisht rënduese dhe të akuzuarit i ka shqiptue dënim me burgim me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate në praninë e rrethanave lehtësuese, të konstatuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë e posaçërisht nga pranimi e fajësisë, pendimin e tij për veprën që ka kryer, se më parë nuk ka qenë i gjykuar dhe se ndaj saj nuk zhvillohet procedurë për ndonjë veprë tjetër penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, qëndrimin e tij korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor e edhe në seancën e gjykatës së shkallës së dytë, faktin se të dëmtuarit –pridërit e tij në sencë pranë kësaj gjykate ndaj të akuzuarit nuk i bashkangjiten ndjekjes penale dhe nuk parashtrojn kërkesë pasuroro juridike si dhe pendimin e të akuzuarit për veprën e kryer dhe në mungesë të rrethanave rënduese e dhe atyre posaçërisht rënduese, kjo gjykatë e ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendimin për dënimin dhe të akuzuarit i shqiptoj dënim të kushtëzuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se një dënim i tillë është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e peronave tjerë nga kryerja e veprave

penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.363/17, datë 06.04.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljana Rexhiq